



U PROTOKOLLUA  
Nr. 3363/1 Prot.  
Datë, më 12.12.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
DREJTORIA E KOORDINIMIT INSTITUCIONAL  
SEKTORI I KOORDINIMIT, STUDIMEVE DHE INTEGRIMIT

Nr. 1725/prot.

Tiranë, më 12.12.2024

Lënda: Kthim përgjigje.

**KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

**TIRANË**

Në përgjigje tuajës me Nr.3363 Prot., datë 27.11.2024, me të cilën kërkonti informacion të përditësuar, lidhur me hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, ju përcjellim informacionin si më poshtë:

- Nga të dhënat e periudhës 9 mujore Janar-Shtator 2024 të Zyrës së Statistikës në Prokurorinë e Përgjithshme, rezulton se në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm nuk janë regjistruar procedime penale të reja, por janë kryer hetime për 48 procedime penale që lidhen me veprat penale në fushën e zgjedhjeve, të mbartura nga viti 2023. Procedimet janë në ngarkim të 6 personave nën hetim dhe 4 të pandehurve, prej të cilëve 1 me masë sigurimi “Arrest në burg”.
- Procedimet janë regjistruar për veprat penale të parashikuara nga nenet 325, 326/1, 326/a, 327, 327/a, 328/a, 329/1, 330, 330/a, 331 të Kodit Penal.
- Janë përfunduar hetimet për 16 procedime penale, nga të cilat janë pushuar hetimet për 9 procedime penale, janë pezulluar hetimet për 2 procedime dhe janë kaluar për gjykim 5 procedime, me 5 të pandehur, njëri me masë sigurimi “ Arrest në burg”. Kurse 32 procedime penale janë akoma në fazën e hetimeve paraprake.
- Kohëzgjatja e hetimeve të procedimeve penale të regjistruara për vepra penale në fushën e zgjedhjeve, me persona nën hetim/ pandehur, varion nga 9 deri 12 muaj. Kurse procedimet penale në proces hetimi kanë kohëzgjatje mbi 12 muaj.
- Përgjatë periudhës 9 mujore kanë qenë në proces gjykimi 7 procedime penale (2 procedime të mbartura nga viti 2023 dhe 5 procedime kaluar për gjykim në vitin 2024). Ka përfunduar gjykimi për 4 procedime, me 16 të pandehur, për të cilët është aplikuar neni 59 i Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe

vënia në prove”. Një i pandehur është deklaruar i pafajshëm dhe është ushtruar apel nga prokurori ( nuk ka të dhëna për shqyrtimin e çështjes në Apel).

- Në lidhje me të pandehurit dhe personat nën hetim (të cilët janë në hetim ose ka përfunduar hetimi) rezultojnë 1 femër dhe 13 meshkuj, banues kryesisht në fshat dhe vetëm 4 prej tyre në qytet, me gjendje gjyqësore të pa dënuar, të grupmoshave mbi 18 vjeç.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin,

**DREJTORI**

**Kostaq Beluri**

